



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRES
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2224/2 Prot.

Durrës, më 15 . 11 .2024

VENDIM

Nr. 54 , datë 15.11 2024

PËR

**"MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË TË
STUDIMEVE, BACHELOR NË "TEKNIK LABORATORI", NË FAKULTETIN E
STUDIMEVE PROFESIONALE, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU"
DURRES"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr.1, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Statutin e UAMD-së, Rregulloren e UAMD-së, si dhe Relacioni nr. 1723/4 prot., datë 31.10.2024 e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë; vendimi i Senatit Akademik nr.20, datë 06.11.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së programit të ciklit të parë të studimeve, Bachelor në "Teknik Laboratori", në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Programi i studimit do të realizohet pranë Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore.
3. Tarifa vjetore për këtë program studimi do të jetë 25.000 lekë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe e Standardeve të Cilësisë
5. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

